

**VENDIM**  
**Nr.1534, datë 19.11.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.662, DATË 8.10.2004 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË**  
**PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE**  
**NË PËRDORIM, TË BASHKISË SË KUÇOVËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.662, datë 8.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Përmasat e pronave nr.4 deri nr.8, 16, 17, 85, 86, 433, 444, 465, 475, 477, 479, 484, 490, 491 e 495, në bashkinë Kuçovë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularët 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

b) Shtohen pronat me nr.557 deri 567, sipas formularëve “Shtesa 1” e “Shtesa 2”, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Bashkisë së Kuçovës i transferohen pronat, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Kuçovës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Bashkia Kuçovë

Lidhja nr.1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b> | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 557,564,565,566                                         | Prona që shërbejnë për shërbime të ndryshme dhe zhvillim ekonomik. | Në pronësi                  |
| 558,563,567                                             | Prona që shërbejnë për strehim.                                    | Në pronësi                  |